

**Deklarata afatgjatë e furnitorit për produktet që nuk kanë status të origjinës preferenciale**

Deklarata e furnitorit, teksti i së cilës është dhënë më poshtë, duhet të plotësohet në përputhje me shënimet shpjeguese në fund të faqes. Megjithatë, shënimet sqaruese nuk duhen riprodhuar.

**DEKLARATË**

Unë, i nënshkruari, furnizuesi i mallrave të mbuluar nga ky dokument bashkëngjitur, të cilat janë të dërguara rregullisht.....<sup>(1)</sup>, deklaroj që :

1. Materialet e mëposhtme të cilat nuk kanë statusin origjinues preferencial janë përdorur në Shqipëri për të prodhuar këto mallra:
- 2.

Përshkrimi i mallrave të furnizuar <sup>(2)</sup>	Përshkrimi i materialeve jo-origjinuese të përdorur	Kreu tarifor NK i materialeve jo-origjinuese të përdorur <sup>(3)</sup>	Vlera e materialeve jo-origjinues të përdorur <sup>(4)</sup>
			Totali:

2. Të gjitha materialet e tjera të përdorura në Shqipëri për të prodhuar këto mallra origjinojnë në .....<sup>(5)</sup> dhe plotësojnë rregullat e origjinës që drejtojnë tregtinë preferenciale me .....<sup>(6)</sup>,dhe

Unë deklaroj se:<sup>(7)</sup>

- Kumulimi është zbatuar me ..... (emri i shtetit/shteteve)
- Nuk është zbatuar kumulim

Kjo deklaratë është e vlefshme për të gjitha ngarkesat e këtyre produkteve të dërguara nga ..... për në .....<sup>(8)</sup>.

Unë marrë përsipër të informoj menjëherë ..... nëse kjo deklaratë nuk është më e vlefshme.

Unë marrë përsipër të vë në dispozicion të autoriteteve doganore çdo dokument tjetër mbështetës që ata kërkojnë:

.....<sup>(9)</sup>  
 .....<sup>(10)</sup>  
 .....<sup>(11)</sup>

<sup>(1)</sup> Emri dhe adresa e klientit.

<sup>(2)</sup> Kur fatura, nota shpërndarëse ose dokumentat e tjerë tregtarë për të cilën deklarata është e bashkëlidhur lidhet me një llojshmëri produktesh ose produktet nuk janë inorporuar me të njëtin proporcion të materialeve jo-origjinuese, furnitori duhet qartësisht t'i diferencojë ato midis tyre.

**Shembull:**

Dokumenti përfshin modele të ndryshme të motorëve elektrik të kreut tarifor “8501” të përdorur në industrinë e makinave të larjes të kreut tarifor “ 8450”. Natyra dhe vlera e materialeve jo-origjinuese të përdorur në industrinë e motorave varion nga një model në një tjetër. Modelet duhet të renditen në mënyrë të ndarë nga njëri-tjetri në kolonën 1 dhe informacioni në kolonat e tjera, duhet të jepet për secilin, kështu që prodhuesi i makinave larëse të mund të vlerësojë në mënyrë të saktë statusin origjinues për secilin nga produktet e tij në varësi të tipit të motorit që inorporohet.

<sup>(3)</sup> Të plotësohet vetëm ku ka lidhje me të.

**Shembull:**

Rregulli për veshjet të ex Kapitullit 62 lejon përdorimin e fillit jo-origjinues . Për rrjedhojë nëse një prodhues veshjesh shqiptar përdor pëlhurë të thurur në Serbi nga fill jo-origjinues, furnizuesi shqiptar duhet të fusë në kolonën 2 të deklaratës së tij vetëm ‘filli’(yarn) si një material jo-origjinues– kreu tarifor NK dhe vlera e fillit me të cilin i referohet janë të parëndësishme për t’u plotësuar.

Një firmë që prodhon tel prej hekuritë kreut tarifor të NK“ 7217” nga shufra hekuri jo-origjinuese duhet të fusë në kolonën 2 përshkrimin si ‘shufra hekuri’(iron bars). Në qoftë se teli do të inkorporohet në një makineri për të cilën rregullat e origjinës së set-it ka vendosur një përqindje limit mbi vlerën e materialeve jo-origjinuese të përdorura, vlera e shufrave duhet të futet në kolonën 4.